



Materiale ndihmëse didaktike dhe pedagogjike

1. Spelling game – Cognitive Alphabet Spelling And Exercise Thinking English Words Exercise Artifact

Prej disa vitesh, anglishtja është vendosur si gjuhë e huaj e detyrueshme që në klasën e parë. Gjithashtu mësimi i anglishtes po eksperimentohet edhe tek fëmijët e grupmoshës 5-6 vjeç (në disa grupe të treta dhe në disa klasa përgatitore).

Nga kjo kuptohet rëndësia e madhe që ka mësimi i anglishtes sipas veçorive të fëmijëve të kësaj grupmoshe. Meqëëense fëmijët në këtë grupmoshë mësojnë më mirë dhe më shpejt, nëse përfshihen në mënyrë aktive në atë që po bëjnë, atëherë materialet didaktike dhe pedagogjike që po ju paraqesim në video, i plotësojnë këto kritere. Sepse ato janë: mbështetëse, nxitëse, praktike, tërheqëse, etj. Nëpërmjet përdorimit të tyre, fëmijët dhe nxënësit mësojnë të njohin shkronjat e anglishtes një e nga një dhe të shkruajnë fjalë të ndryshme.

Shkronjat janë prej druri dhe madhësia e shkronjave prej druri është njëlloj sa madhësia e shkronjave me pika që formojnë fjalët anglisht, tek kartelat me figura dhe fjalë të shkruara më shkronja të pikëzuara.

Materiali prej të cilit janë ndërtuar shkronjat anglisht është dru ekologjik të lyera me bojëra johelmuese.

Këto materiale didaktike janë ndërtuar mbi bazën e parimeve të Montesorit, sipas së cilës: struktura dhe i gjithë procesi i edukimit duhet të vihen në shërbim të nevojave të fëmijëve dhe jo të asaj se çfarë mendojnë të rriturit.

Këto materiale janë mbështetëse, nxitëse, praktike etj., të cilat i ndihmojnë fëmijët dhe nxënësit që të mësojnë në mënyrë sa më të thjeshtë dhe praktike anglishten. Nëpërmjet përdorimit të tyre, fëmijët dhe nxënësit mësojnë të njohin shkronjat e

anglishtes një e nga një, të shqiptojnë tingujt e anglishtes dhe të shkruajnë fjalë të ndryshme sipas modelit të kartelave që i shoqërojnë.

1. Kutia përmban: 52 shkronja të vogla (ose 26 shkronja të vogla, nga dy herë) për të lexuar e shkruar fjalët anglisht.
2. Fëmijët jo vetëm do të mësojnë anglisht, por edhe do të përforcojnë ngjyrat, sepse shkronjat janë me ngjyra të bukura e tërheqëse për fëmijët.
3. Kartelat kanë të shkruara fjalë anglisht në të dyja anët.
4. Kartelat janë të përbëra prej kartoni të cilësisë së lartë. Letra është e butë, skajet nuk janë të mprehta, nuk shkakton lëndime dhe vizatimet janë të qarta.
5. Shkronjat janë prerë me teknologji të lartë me lazer, janë elegante, të buta, nuk i gërvishtin fëmijët dhe prekja e tyre të krijon ndjesinë e delikatesës.
6. Shkronjat janë të përbëra nga dru i plotë, janë të forta dhe të përshtatshme për të luajtur.
7. Madhësia e kartelave dhe e shkronjave përshtaten me moshën e fëmijëve.
8. Fëmijët do të ndërtojnë fjalë me shkronjat anglisht.
9. Kur të mbaroni shkronjat futini te qesja prej pëlhure.